

se do t ikij, do vete, ja se do gjij birëne, ja se prapë nuku kënenem. Edë mbreti i da pará, sa deši; ë mori edë iku, vate më në vend, kë ish skaë, kë papórëte ë kaikatë e duñasë gjithë atjë nek ajó skale do kënéshin, ë vate atjë ë beri në han të madë edë porsiti, kë túdo i huaj kë të vij nek ai vend, të vij në han ë të haj pa paguar; edë hizmekarëte i kiš gjithë vašaz; edë zuri atë vend atjë edë prit.

Hajdute djälene e muraë ë e špune në tjetërë vend mërguar; ë atjë e šin, j a danë nëit tšifutit. Ai tšifuti kiš në nisi gjithë gur; ë mori djälene, mori edë hekura, kazmá edë të tjera, tš i duhešin, ë e špie djälene nek ajó nisja ë i ðote, kë »kur të bitisëtš ketë nisine ë t e betš veštë, atë herë do të lešój«. Kur še djali gjithë atë nisi, e pa, kë më andej nuku iken, sa të rón; u-ngre në dite, mori kazmáne ë zuri të punón. Atjë kë zuri proto, ish në dras e made, ë si ngriti drásene, nëne drase ishë flori šumë, sa të mbutëj në kaikë; ë mirë, kë i gëti florite, po tšiš t u ben? se as ngaha iken, kiš, as kaiken, të mirë parát. Aštú ndëni mbi drase ë i bij tamburait; atjë afërë skonej në papuar me askër, ë si diguane tamburane, u-këde papori ë vate atjë, nek ish djali, edë dergoi kapetani ë e mori në papuar e pjeti, i ðote: »Pse je ketú ti?« I ðote djali, kë »mua më ka blerë në tšifút sklav edë më ka derguare ketú, kë të bij ketë nisine vešt«. I ðote kapetani, kë »eja me neve, t ikim«; i ðote djali, kë »u nuku ikij pa bitisurë punen«. Pasandajet kapetani dergoi të gjithë askerin, kë kiš, ë punojen për në zet dit, i këdien guret, i hodë në det, edë u-bë nisja arë. Pastajet kapetani dergoi ë mori dri edë i vunë; edë mbeti kapetani atjë bashkë me askër edë me papuar gášte muaj. Në gášte muaj erdi tšifuti, kë t i špij bukë djalit, edë e pa nisine, po s mund t e një; se nga gur, kë kiš, ish berë vešt. Aštú vate tšifuti atjë; i ðote djali, kë »u tani punëne t a sosa, po të më japš urátene, edë t ikij«. I ðote tšifuti, kë »nuku të lë, se kam pun akomi«, edë e mori djälene në kaikë edë vate në vend të tij; si e špuri atjë djälene, u ða gjithëvet tšifutet mbëdi, kë »ki djali më beri nisine vešt, edë tani t i japëmë bakšišin edë t e lemë të veje në punë të tij«. Aštú i danë të gjithë bakšiš, sa s kiš, se ku t i vij; edë e lešuan, të vij në punë të tij. Atjë si doli djali të ben sulatso për jašte kasabase, atjë mbi në kšiparis pa në folë zogu; ðote: »Të vete të šo atë folenë, se tšiš ka«. Aštú hipi mbi kšiparis ë vete në folë; atjë gëti të tre gúrate dževairë, kë i kiš maë ipja. Pastajet i ðot i zoti, kë »tš do nga mua?« I ðote djali: »Në kaikë me krip